



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
FAKULTETI JURIDIK

Tel: + _____ URL: <http://www.uni-gjilan.net>
Fax: + _____ E-Mail: juridiku@uni-gjilan.net

Komisioni Dicipinor

Ref. nr. 178/18 Gjilan, 12.10.2018

Komisioni Dicipinor i Fakultetit Juridik – Universiteti "KADRI ZEKA", i caktuar me vendim të Këshillit të Fakultetit Juridik të datës 24.09.2018, në përbërje Ass. Selim Daku, PHD.c. – kryetar, Ass. Liridon Dalipi, PHD.c. – anëtar dhe ass. Dctrina Alishani, Phd.c. – anëtare, duke vepruar në pajtim me rregulloren për masat dhe procedurën dicipinore për personelin akademik dhe studentët, rregullore për Kodin e Etikës në UKZ nr.02/2018 dt.07.12.2016 dhe Masa dicipinore shtesë për mbarvajtjen sa më të mirë të provimeve, kollokviumeve dhe testeve nr.01/15b dt.05.12.2014, pas shqyrtimit të paraqitjes dicipinore, kundër studentit të poshtëshënuar për shkeljen e supozuar, më datë 24.09.2018, sjellë

VENDIM

Me të cilin vërtetohet se:

Studenti me numër të ID-së 17031156, student e Fakultetit Juridik, me qëllim të kopjimit ka përdorur paisjen elektronike me mikrofoni dhe dëgjuese në lëndën E Drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në mbarvajtje të prof.dr. Dukagjin Leka dhe Ass. Selim Daku, vepër kjo e cila konsiderohet shkelje dicipinore e studentit e sanksionuar me dokumentin për Masat dicipinore shtesë, të bazuar në nenin 17 në rregulloren për masat dhe procedurën dicipinore për personelin akademik dhe studentët, dhe nenin 14 të Kodit të Etikës së UKZ-së.

Andaj, duke u bazuar në paragrafin IV të Masave dicipinore shtesë, Komisioni Dicipinor i Fakultetit Juridik të UKZ-së, vendos që të sipërshënuarit t'i shqiptoj masën dicipinore:

Ndalim në paraqitje dhe hyrje në provime për 1 (një) afat të provimeve (afatin e nëntorit 2018):

- I. Masa fillon të zbatohet nga data 01.10.2018 deri më 15.01.2019
- II. Shërbimi i administratës detyrohet që shkelësit t'i pamundësojë ofrimin e shërbimeve deri më 15.01.2019.
- III. Urdhërohet edhe shërbimi SEMS që të bëjë bllokimin e ofrimit të shërbimeve elektronike deri më datë 15.01.2019.
- IV. Studenti ka të drejtë të paraqesë dhe nënshtrohet provimeve nga afati i janarit 2019.

Arsyetim

Dekani i Fakultetit Juridik në bazë të raportit të profesorit të lëndës ka paraqitur në Komisionin Diciplinor Fletëparaqitjen kundër studentit të sipërshtënuar me dyshimin që gjatë procesit të mabjtjes së provimit nga lënda E drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të kundërligjshme ka përdorur paisjen elektronike me mikrofon dhe dëgjuese. Komisioni Diciplinor pas shqyrtimit të provave ka konstatuar se i sipërpërmenduri ka vepruar në kundërshtim me aktet ligjore të UKZ-së dhe Masat diciplimore shtesë për mbarvajtjen sa më të mirë të provimeve, kollokviumeve dhe testeve nr.01/15b dt.05.12.2014 të UKZ-së dhe në mënyrë të kundërligjshme ka kryer deliktin diciplinor.


Bazuar në argumentet e prezentuar më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni diciplinor:

Ass. Selim Daku, Phd.c. – Kryetar -

Ass. Liridon Dalipi, Phd.c. – anëtar -

Ass. Detrina Alishani, Phd.c. – anëtar -



Udhëzim Juridik:

Kundër këtij vendimi palës i lejohet ankesa e cila duhet të i drejtohet Komisionit të Ankesave të Fakultetit Juridik. Afati i ankesës është 15 ditë nga dita e marrjes së këtij vendimit.